



KËSHILLI I MINISTRAVE KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 50, datë 25.09.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURË INDUSTRIALE MAGAZINIMI 3 DHE 4 KATE MBI TOKË ME
AMBIENTE MBËSHTETËSE” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjekti zhvillues shoqërisë “4 Vëllezërit Nela” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë industriale magazinimi 3 dhe 4 kate mbi tokë me ambiente mbështetëse”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “4 Vëllezërit Nela” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDAROKA



Nënshkruar më datë 02/04/2025